



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 24 prill 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike tek shoqëria “HEC POLEMI” sh.p.k.

U miratua kërkesa e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Në kuadër të çështjeve të tjera, u trajtua informacioni mbi depozitimin e kontratës së Zyrtarit të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a., si dhe informacioni mbi realizimin e të ardhurave nga pagesa rregullatore dhe propozimi për miratimin e shtyrjes së afatit të pagesës.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.